



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2025

Lënda: GJEOGRAFI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT


1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Dita është më e gjatë se nata në datën 22 qershor në: 1 pikë
- A) Australi.
 B) Argjentinë.
 C) Afrikën e Jugut.
 D) Britaninë e Madhe.

2. Në figurë tregohet:

- A) eklipsi i Diellit.
 B) eklipsi i Hënës.
 C) faza e çerekut të parë të Hënës.
 D) faza e çerekut të fundit të Hënës.



1 pikë

3. Supozojmë se temperatura maksimale gjatë ditës është 27°C, ndërsa ajo minimale është 10°C. Sa është amplituda ditore e temperaturës? 1 pikë


- A) 17°C
 B) 10°C
 C) 7°C
 D) 1°C

4. Si ndryshon kripësia e ujërave detare në drejtim horizontal (nga ekuatori drejt poleve)? 1 pikë

- A) Rritet me rritjen e gjerësisë gjeografike.
 B) Rritet nga tropikët në drejtim të poleve.
 C) Rritet nga ekuatori në drejtim të tropikëve.
 D) Rritet nga gjerësitë mesatare në drejtim të poleve.

5. Cilën formë të relievit lumor tregon figura e dhënë? 1 pikë

- A) Meandrin.
 B) Kanionin.
 C) Estuarin.
 D) Deltën.



1 pikë

6. Cili nga mineralet e mëposhtme nuk mund të gërvishtë asnjë mineral tjetër? 1 pikë

- A) Kuarci.
 B) Topazi.
 C) Kalciti.
 D) Talku.

7. Cila nga alternativat e mëposhtme është karakteristike e shkëmbinjve magmatikë efuzivë? 1 pikë


- A) Përbëhen kryesisht prej kalciti dhe kanë ngjyrë të bardhë.
 B) Kanë pak kristale për shkak të ftohjes së shpejtë të magmës.
 C) Kanë shumë kristale për shkak të ftohjes së ngadaltë të magmës.
 D) Formimi i tyre vjen si pasojë e procesit të shkatërrimit-depozitimit-diagjenezës.

8. Në pjesën më të madhe të sipërfaqes së Kosovës klima është: 1 pikë

- A) detare.
 B) malore.
 C) mesdhetare fushore.
 D) mesatare kontinentale.

9. Cili është shkak i shmangies së erërave nga Poli i Veriut dhe Poli i Jugut? 1 pikë


- A) Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet.
 B) Forma e shtypur e Tokës në dy polet.
 C) Pjerrësia e boshtit të Tokës përkundrejt planit të orbitës së Tokës.
 D) Ndryshimi i raportit tokë – det midis Hemisferës së Jugut dhe asaj së Veriut.



1 pikë

10. Fosilet shërbejnë për të përcaktuar: 1 pikë
- A) moshën e shtresave gjeologjike të Tokës.
 B) vendndodhjen e dikurshme të tërmeteve.
 C) trysninë në brendësi të Tokës.
 D) moshën absolute të Tokës.

11. Shformimet e shtresave shkëmbore të treguara në figurë janë formuar si rezultat i: 1 pikë
- A) lëvizjeve luhatëse.
 B) lëvizjeve eustatike.
 C) lëvizjeve shkëputëse.
 D) lëvizjeve rrudhosëse.



12. Mbeti i pandryshuar nga ndarja e fundit administrative e Shqipërisë (viti 2014) numri i: 1 pikë
- A) rretheve.
 B) qarqeve.
 C) bashkive.
 D) komunave.

13. Bën pjesë në sektorin e tretë të ekonomisë: 1 pikë
- A) turizmi.
 B) bujqësia.
 C) blegtoria.
 D) industria.

14. Cili nga rajonet gjeografike të Shqipërisë ka dalje të gjerë në detin Jon? 1 pikë
- A) Rajoni Verior dhe Verilindor.
 B) Rajoni Perëndimor.
 C) Rajoni Juglindor.
 D) Rajoni Jugor.

15. Lugina e Shkumbinit të Mesëm shërben si kufi jugor për: 1 pikë
- A) Rajonin Verior dhe Verilindor.
 B) Rajonin Perëndimor.
 C) Rajonin Juglindor.
 D) Rajonin Jugor.

16. Cilët janë dy faktorët kryesorë që kanë ndikuar në modelimin e ashpër të relievit të Alpeve Shqiptare? 1 pikë
- A) Relievi i larmishëm dhe hidrografia e pasur.
 B) Pasuritë e mëdha minerale dhe reshjet e shumta.
 C) Formacioni i larmishëm gjeologjik dhe klima e ashpër.
 D) Strukturat rrudhosëse dhe shumëllojshmëria e mineraleve.

17. Kanali i Suezit, ngushtica e Hormuzit dhe ngushtica e Gjibraltarit janë të rëndësishme, sepse ato: 1 pikë
- A) parandalojnë sulmet nga shtetet kufitare.
 B) kontrollojnë rrugë të rëndësishme tregtare.
 C) pengojnë lëvizjen e anijeve që transportojnë armë bërthamore.
 D) i japin mundësi Kanadasë të ketë akses në portet që nuk ngrijnë gjatë dimrit.

18. Një karakteristikë e përbashkët e zonave fiziko – gjeografike të vendosura në kuadrat është se të gjitha: 1 pikë
- A) kanë sipërfaqe të mëdha të tokave të punueshme.
 B) janë qendrat kryesore të besimeve fetare.
 C) gjenden midis luginave të lumenjve.
 D) kanë dendësi të ulët të popullsisë.

- *Pllaja e Siberisë*
- *Shkretëtira e Saharasë*
- *Pellgu i Amazonës*
- *Stepat e Mongolisë*

19. Nëse një shtet ka një moshë mesatare të re të popullsisë, ky është një tregues kryesisht i:

1 pikë

- A) përqindjes së ulët të popullsisë së aftë për punë.
- B) përqindjes së lartë të grupmoshës 0 – 14 vjeç.
- C) nivelit të lartë të vdekshmërisë.
- D) nivelit të ulët të emigrimit.


20. Popullsia botërore është e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë. Në cilën nga zonat është përqendruar pjesa më e madhe e popullsisë?

1 pikë

- A) Në Hemisferën Jugore.
- B) Në Hemisferën Veriore.
- C) Në zonat me klimë ekuatoriale.
- D) Në gjerësitë e mëdha gjeografike.

21. Vëzhgoni hartën.

Harta e Botës




a) Përcaktoni llojin e projeksionit hartografik të përdorur.

1 pikë

b) Në hartën e mësipërme sipërfaqja e Groenlandës është më e madhe krahasuar me atë të Australisë, ndërkohë që në realitet është e kundërta. Pse ndodh kjo? Jepni një argument për të mbështetur përgjigjen tuaj.

2 pikë

22. Figura tregon një nga mënyrat e formimit të reshjeve.



a) Shpjegoni si formohen reshjet e treguara në figurë.

2 pikë

b) Emërtoni një lloj tjetër të reshjeve sipas mënyrës së formimit të tyre.


1 pikë

23. Përcaktoni tri kushte që valët detare të shkaktuara nga era, të arrijnë përmasa të mëdha.


3 pikë

24. Në figurë jepet ndërtimi i brendshëm i Tokës, në të cilën dallohen qartë shtresat e saj: korja e Tokës, manteli dhe bërthama. Jepni tri karakteristika të kores së Tokës.

3 pikë



25. Grafiku tregon intensitetin e tjetërsimit fizik dhe kimik për zona të ndryshme klimatike.



a) Shpjegoni pse në zonën e klimës së nxehtë dhe të thatë është më i zhvilluar tjetërsimi fizik.

2 pikë

b) Cili lloj i tjetërsimit zhvillohet në zonën e klimës së nxehtë dhe të lagësht, krahas atij fizik dhe kimik të treguar në grafik?

1 pikë

26. Shkruani tri ndryshime midis liqenit të Ohrit dhe atij të Shkodrës në aspektin fiziko-gjeografik:

3 pikë

Liqeni i Ohrit	Liqeni i Shkodrës
1.	1.
2.	2.
3.	3.

27. Në tiparet strukturore të popullsisë së Shqipërisë vend të rëndësishëm zë dhe struktura e saj sipas vendbanimit (qytet-fshat). Tradicionalisht në strukturën e popullsisë shqiptare, sipas vendbanimit, ka mbizotëruar popullsia banuese në fshat.

a) Çfarë ndryshimi solli në strukturën e popullsisë sipas vendbanimit regjistrimi i popullsisë i vitit 2011?

1 pikë

b) Identifikoni dy nga faktorët që ndikuan në këtë ndryshim.

2 pikë

28. Rajoni Jugor përfaqëson një nga rajonet gjeografike të Shqipërisë.

a) Çfarë e dallon ndërtimin gjeologjik të këtij rajoni në krahasim me rajonet e tjera? **1 pikë**

b) Cila njësi fiziko-gjeografike që gjendet në jug të rajonit është formuar në një graben? **1 pikë**

c) Cili drejtim i relievit mbizotëron më shumë në këtë rajon? **1 pikë**

29. Evropa dallohet për larminë natyrore të saj.

a) Evidentoni dy karakteristika të pozitës gjeografike të Evropës. **2 pikë**

b) Nëpërmjet cilit kanal mundësohet lidhja e Evropës me vendet e Lindjes së Mesme në rrugë ujore? **1 pikë**

30. Renditni tre nga faktorët e formimit të klimës së makrorajonit rus. **3 pikë**

31. Në gjysmën e dytë të shekullit XX lindi koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm.

a) Pse lindi nevoja e trajtimit të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm? **1 pikë**

b) Përshkruani tri shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm. **3 pikë**

32. Rajoni i Afrikës Nënshaharane është një ndër rajonet e mëdha gjeografike të botës. Evidentoni tri veçori të hidrografisë së këtij rajoni. **3 pikë**

33. Më poshtë jepet harta e Amerikës së Veriut.



- a) Identifikoni një nga zonat më të populluara të saj (Hijezoni me stilolaps në hartë). **1 pikë**

- b) Cila është prejardhja e pjesës më të madhe të popullsisë? **1 pikë**

- c) Në Amerikën e Veriut niveli i shtimit natyror të popullsisë është i ulët. Jepni një nga faktorët që ka ndikuar. **1 pikë**
